

Të dashur prindër apo kujdestarë:

HIV/AIDS është një nga problemet shëndetësore më serioze që Amerikanët kanë pasur ndonjëherë. Nuk ka kurë dhe edukimi është e vetmja mënyrë me të cilën mund të ndihmojmë fëmijët tanë të mbajnë veten nga përhapja e HIV-it, virusi që shkakton AIDS-in.

Shkolla jonë do të fillojë të mësojë fëmijën tuaj mbi Acquired Immune Deficiency Syndrome (AIDS). Departamenti i arsimit i shtetit të New York-ut dhe departamenti i arsimit i qytetit të New York-ut e kanë bërë të detyrueshme mësimin mbi HIV/AIDS për të tërë nxënësit nga kopshti deri në klasën e 12. Kjo rregullore thotë se mësimi mbi HIV/AIDS duhet të jetë i përshtatshëm me moshën dhe të shqyrtojë natyrën e sëmundjes, metodat e transmetimit dhe metodat e parandalimit. Mësimet përqendrohen në zhvillimin e kuptimit të sëmundjeve ngjitëse, mënyra për jetë më të shëndetëshme dhe si të përdoren burimet e komunitetit për një jetë më të mirë.

Sipas rregullave të shtetit të tërë nxënësit duhet të marrin pjesë në mësimet mbi natyrën e sëmundjes dhe metodat e transmetimit. Por prindërit apo kujdestarët ligjorë kanë të drejtë të kërkojnë që fëmija të mos marrë pjesë në mësimet mbi metodat e parandalimit. Këto mësimet janë të titulluara "Parandalimi". Prindërit apo kujdestarët që dëshirojnë të bëjnë këtë kërkesë, duhet të bëjnë një kërkesë me shkrim tek drejtori i shkollës së fëmijës ku kërkohet që fëmija të mos marrë pjesë në këto mësimet, dhe të marrin përsipër që t'i mësojnë këto mësimet fëmijën në shtëpi.

Një këshill mbi HIV/AIDS i përbërë nga anëtarë të panelit mbi rregullat e arsimit, përfaqësues të komunitetit, prindër, mësues dhe mbikëqyrës e ka shqyrtuar hollësisht dhe aprovuar programin dhe materialet që do të përdoren. Gjithashtu programi është shqyrtuar dhe aprovuar nga departamenti i Shëndetësisë dhe i Higjienës Mendore të qytetit të New York-ut.

Inkurajoni fëmijën tuaj të flasë me ju mbi HIV/AIDS-in. Ju mund t'i referoheni artikujve mbi HIV/AIDS-in në gazeta apo revista për t'i diskutuar sëbashku. Kjo gjë mund t'ju ndihmojë në sqarimin e fëmijës se si transmetohet HIV-i dhe të krijojë mundësi për t'i treguar fëmijës tuaj se si abstenimi nga seksi dhe alkooli dhe droga është mënyra më e duhur dhe më efektive për mbrojtjen e shëndetit dhe të ardhmes së tyre.

Ne e mirë presim aktivizimin tuaj në shkollë. Për shembull kemi nevojë për prindër në ekipet e shkollave të mesme mbi HIV/AIDS-in dhe për koordinimin e prezantimeve të PTA mbi HIV/AIDS-in. Flisni me mësuesin e fëmijës tuaj, koordinatorin me prindërit apo me mua se si mund të ndihmoni mësimet mbi HIV/AIDS-in.

Në qoftë se keni ndonjë pyetje mbi këtë program apo do të dëshironit të shqyrtonit materialet e programit mbi HIV/AIDS ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni.

Sinqerisht,
Drejtore

Ju lutemi merrni pjesë në takim me prindër për programin e rifreskuar mbi HIV/AIDS-in në

Vendi:

Data (mm/dd/yy):

Ora:

Mësimet mbi HIV/AIDS-in do të mbahen në klasë nga

Data (mm/dd/yy):

deri në

Data (mm/dd/yy):